



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
ZYRA E Kryeministrit - URE E PRIME MINISTRI - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Stafi Org. Org. Unit	02.1.a
Nr. Prot. Prot. No.	731
Nr.faqeve Nr. shënies No. pages	- 2 -
Data: Date:	23 06/2026
Prishtinë/a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Datë: 23.06.2026**

Mbledhja e 25-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 24.06.2026, në orën 09:00, ndërtesa e Qeverisë, salla P-31.

**RENDI I DITËS**

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve dhe të transkripteve të mbledhjeve 19 dhe 20 dhe ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve 21, 22, 23 dhe 24 elektronike\korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e qiradhënies sipas kërkesës së Agjencisë Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kohëzgjatje prej 15 vite për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror, zona kadastrale Seqisht Komuna Hani i Elezit (ZKM)
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve buxhetore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit në 4 (katër) projekte kapitale të reja në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkuara nga Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe kryetarët e komunave përkatëse (MIT)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve buxhetore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në 4 (katër) projekte kapitale në përputhje me 4 (katër) marrëveshjet për mbështetje financiare për projektet kapitale të nënshkuara nga Ministri i MAPL-së dhe kryetarët e komunave përkatëse (MAPL)
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndalimin e ekzekutimit të Rregullores për pranimin dhe trajtimin e thirrjeve telefonike në sistemin e caktimit të avokatëve, sipas detyrës zyrtare (ex-officio) të Odës së Avokatëve të Kosovës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente (MD)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndalimin e ekzekutimit të aktit administrativ mbi lartësinë e shpenzimeve për regjistrim Odës së Avokatëve të Kosovës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente (MD)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (MD)
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve buxhetore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në pajtim me Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projekteve të nënshkuara nga Ministri i Zhvillimit Rajonal dhe Kryetarët e Komunave (MZHR)

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit: Sanimi i Rrëshqitzës në rrugën: Hani i Elezit-Gorancë (MMPH)
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i Projektit: Rehabilitimi i rrugës Rajonale R112, segmenti: Gjonaj-Bishtazhin (MMPH)
11. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore, për financimin e furnizimit dhe instalimit të një gjeneratori të ri në Burgun e Sigurisë së Lartë (MF)
12. Shqyrtimi i Kërkesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për Ndërmarrjen Shoqërore "Komogllava" (MF)
13. Shqyrtimi i Nismës për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për KOMPAS - Projekti i Qasjes Gjithëpërfshirëse të Kosovës për Forcimin e Sistemit Shëndetësor (MF)
14. Të ndryshme